

# Numri i mësimdhënësve në komuna: tepriçë apo nevojë?

(Ndikimi i ndryshimeve në grantin për arsim në komuna)



Numri i mësimdhënësve në komuna:  
tepricë apo nevojë?

(Ndikimi i ndryshimeve në grantin  
për arsim në komuna)

—  
Qershor 2026

— **Përmbajtja**

Përmbledhje ekzekutive	4
Hyrje	5
Metodologjia, qëllimi, shtrirja dhe kufizime e raportit	6
1. Efekti i formulës së re të grantit të arsimit në nivel komunal	7
2. Ndikimi financiar i formulës së re të grantit të arsimit në komuna	11
3. Përfundim dhe rekomandime	13

## Përmbledhje ekzekutive

Gjatë vitit 2026, Ministria e Financave ka nisur zbatimin strikt të formulës për buxhetimin e numrit të mësimdhënësve në kuadër të grantit të arsimit për komunat, duke e përshtatur atë me numrin aktual të nxënësve nëpër komuna. Ndërkaq, në vitet paraprake, zbatimi i Udhëzimit nr. 22/2013 i Ministrisë së Arsimit lidhur me raportin mësimdhënës-nxënës nuk ishte strikt, si dhe komunat nuk kishin përshtatur apo reduktuar numrin e mësimdhënësve në përputhje me numrin në rënie të nxënësve.

Me këtë ndryshim, lista e mësimdhënësve të paraqitur nga komunat nuk merret më automatikisht si bazë për buxhetim, ndërsa nëse komunat raportojnë më shumë mësimdhënës, Ministria nuk i pranon këto pozita si të financueshme dhe, rrjedhimisht, nuk i përfshin në grantin e arsimit. Si pasojë, një numër i konsiderueshëm mësimdhënësish ka mbetur jashtë buxhetimit të granti i arsimit, sepse tejkalon tavanin e lejuar nga normat e përcaktuara nga Ministria e Arsimit.

Kjo mënyrë e re e financimit e zhvendos barrën e vendimmarrjes dhe të kostos drejt komunave. Në praktikë, komunat janë vendosur përballë dy alternativave: të harmonizojnë numrin e mësimdhënësve me normativat e Ministrisë së Arsimit, çka potencialisht nënkupton shkëputje të kontratave të punës për mësimdhënësit e konsideruar "mbi normë" ose të vazhdojnë t'i mbajnë në punë mësimdhënësit shtesë. Nëse komunat zgjedhin alternativën e dytë, atëherë ato duhet t'i mbulojnë pagat e këtyre mësimdhënësve me burime vetanake ose përmes grantit të përgjithshëm, pra duke mbuluar financimin nga linja të tjera buxhetore.

Të dhënat tregojnë, se për gjitha komunat e Kosovës, për vitin 2026, Ministria e Financave ka larguar nga granti i arsimit gjithsej 3,101 mësimdhënës. Për vitin pasues, 2027, është paraparë që edhe 463 mësimdhënës të largohen nga granti i arsimit, përdërisa për të njëjtin vit për disa komuna, së bashku, numri i mësimdhënësve planifikohet të rritet për 200. Ky vendim pritet të krijojë një ngarkesë të konsiderueshme financiare për buxhetet komunale, ku vetëm në vitin 2026, kostoja e vlerësuar për gjitha komunat tejkalon 24 milionë euro. Nëse komunat vazhdojnë të insistojnë në ruajtjen e të njëjtit numër mësimdhënësish edhe në vitet vijuese, kjo kosto pritet të rritet më tej. Në këto rrethana, pagesa e mësimdhënësve të cilët Ministria e Arsimit dhe Ministria e Financave i konsiderojnë "tepricë" apo "mbi normë" do të realizohet duke shfrytëzuar mjete të planifikuara për linja të tjera buxhetore si investimet kapitale, mallra apo subvencionet, e gjithë kjo do të ndikojë që të ulët edhe me tej potenciali i komunave për investime në projekte ose nisma zhvillimore.

Ndikimi nuk kufizohet vetëm të pagat. Granti i arsimit, përveç pagave, financion edhe mallra e shërbime për funksionimin e institucioneve arsimore si dhe investime kapitale në sektorin e arsimit. Për këtë arsye, përjashtimi i mësimdhënësve nga granti dhe rikonfigurimi i buxhetimit pritet të ndikojë edhe në strukturën e përgjithshme të financimit të arsimit në nivel lokal. Për 25 komunat e trajtuara në këtë raport, totali i grantit të arsimit për vitin 2026 është 250 milionë euro, ndërsa për vitin 2027 parashihet që kjo shumë të jetë mbi 5 milionë euro më e ulët.

Sa i përket dallimeve ndërmjet kërkesave komunale dhe aprovimit të numrit të mësimdhënësve nga Ministria e Arsimit dhe Ministria e Financave për vitin 2026, hendeku më i madh vërehet në disa komuna, përkatësisht në Gjilan nuk janë përfshirë në grantin e arsimit 310 mësimdhënës, Kamenicë 299, Gjakovë 290, Podujevë 250, Viti 206, Pejë 139, Malishevë 138, Skenderaj 169, Rahovec 186, Deçan 144, Dragash 115, Klinë 104 dhe në Komunën e Shtimes dhe atë të Mitrovicës së Jugut nga 88 mësimdhënës. Komunat që nuk janë prekur nga ky ndryshim janë Fushë Kosova, Prishtina, Obiliqi dhe Ferizaj, ku është llogaritur që numri aktual i mësimdhënësëve është në përputhje me numrin e nxënësve.

# Hyrje

Numri i nxënësve në Kosovë po shënon rënie të thellë dhe të vazhdueshme. Vetëm gjatë katër viteve të fundit, në nivel vendi, numri i nxënësve ka rënë për më shumë se 30 mijë.<sup>1</sup> Megjithatë, kjo rënie nuk është shoqëruar me të njëjtin trend të zvogëlimit të numrit të mësimdhënësve, as me riorganizimin e rrjetit shkollor përmes transferimit të nxënësve drejt objekteve ku numri i nxënësve është më i madh. Si rezultat, në shumë raste është krijuar një mospërputhje mes numrit të nxënësve, numrit të mësimdhënësve dhe numrit të institucioneve shkollore që mbahen në funksion.

Përkundër ndryshimeve demografike dhe ndikimit të tyre të drejtpërdrejtë në sistemin arsimor, institucionet e Kosovës nuk e kanë përcjellë rënien e numrit të nxënësve me analiza të mjaftueshme dhe me vendimmarrje të bazuar në të dhëna. Mungesa e vlerësimeve të tilla lë të hapura çështje thelbësore për planifikimin arsimor dhe financiar: përfshirë këtu nëse ka nevojë reale për ndërtimin e objekteve të reja arsimore në kushtet e rënies së nxënësve, se si duhet të trajtohet stafi i tepërt i mësimdhënësve, etj., ashtu që shpenzimet publike të jenë të arsyeshme.

Në këtë kontekst, duke u përballur me mospërputhjet ndërmjet numrit të nxënësve dhe strukturës së shpenzimeve në arsim, Ministria e Financave e Kosovës, nga viti 2026 dhe me sugjerimin e Ministrisë së Arsimit, ka nisur të aplikojë formulën e ndarjes së grantit për arsim vetëm në bazë të numrit të nxënësve, dhe jo më në bazë të listës së mësimdhënësve të paraqitur nga komunat, praktikë kjo që është ndjekur deri në vitin 2025.

Kjo pritet t'i nxisë komunat në procesin e riorganizimit të rrjetit shkollor, i cili pritet të bëhet më sistematik, duke e kthyer atë nga një debat politik në një domosdoshmëri të menaxhimit financiar. Kosova ka afro 1,200 objekte shkollore (në sistemin parauniversitar), të ndërtuara kryesisht në periudhën kur vendi kishte rreth 120,000 nxënës më shumë. Prandaj, formula e re e grantit mund t'i nxisë komunat të shqyrtojnë bashkimin e shkollave, mbylljen/transformimin e disa objekteve, dhe transferimin e nxënësve në qendra ku mund të krijohen klasa me madhësi më të qëndrueshme dhe shërbime më cilësore.

Në të njëjtën kohë, riorganizimi i rrjetit nuk duhet të kuptohet si zgjidhje që prodhon automatikisht largime nga puna. Institucionet mund të ndjekin edhe forma të pensionimit të parakohshëm për mësimdhënës, si një instrument tranzicioni për të menaxhuar stafin e tepërt pa krijuar tronditje sociale.

Por, për të mos keqësuar edhe me tej efektin e politikës së re të grantit, komunat duhet të shmangin praktikën e punësimeve të reja në sektorin e arsimit, përveç rasteve kur ka mungesa të dokumentuara në lëndë të caktuara kuadrosh deficitare. Ndalimi i zgjerimit të stafit, krahas menaxhimit të daljes graduale përmes pensionimit dhe riorganizimit të rrjetit shkollor, do të krijonte kushtet që shpenzimet në arsim të lidhen më mirë me numrin e nxënësve dhe me standardet e rekomanduara për raportin nxënës–mësimdhënës.

<sup>1</sup> [Ministria e Arsimit dhe Inovacionit. Statistikat e Arsimit 2021 & 2025.](#)

## Metodologjia, qëllimi, shtrirja dhe kufizimet e raportit

Qëllimi i këtij raporti është zbërthimi ose shpjegimi, në mënyrë objektive dhe të verifikueshme, se çfarë qasje të re po ndiqet në financimin e arsimit parauniversitar përmes grantit të arsimit si dhe të vlerësojë ndikimin potencial të kësaj politike të re në nivel komunal dhe implikimet e saj financiare dhe operacionale.

Për realizimin e këtij raporti është përdorur një qasje e kombinuar kërkimore, e cila përfshin analizën e dokumenteve, analizën statistikore dhe mbledhjen ose verifikimin e të dhënave përmes intervistave me përfaqësues të institucioneve komunale në fushën e buxhetit dhe të arsimit. Kjo qasje është zgjedhur për të siguruar kuptim (shpjegim) sa më të plotë të ndryshimeve të propozuara dhe të ndikimit të tyre të mundshëm në praktikë.

Burimi kryesor i të dhënave për këtë raport kanë qenë dokumentet zyrtare të institucioneve qendrore, veçanërisht dokumentet e Ministrisë së Financave dhe Transfereve dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Inovacionit.

Në kuadër të analizës së dokumenteve janë shqyrtuar: qarkorja buxhetore 2025/01 për përgatitjen e buxhetit për vitin 2026, qarkorja buxhetore 2026/01 për përgatitjen e buxhetit për vitin 2027, dokumentet shpjeguese dhe udhëzimet për ndarjen e Grantit Specifik të Arsimit, raportet statistikore vjetore të arsimit të publikuara nga MASHTI, të dhënat zyrtare mbi numrin e nxënësve, mësimdhënësve dhe institucioneve arsimore dhe dokumente të tjera relevante që lidhen me formulën e financimit të arsimit parauniversitar dhe me menaxhimin e burimeve njerëzore në sektorin e arsimit.

Analiza e këtyre dokumenteve ka mundësuar identifikimin e ndryshimeve ndërmjet qasjeve të financimit të aplikuara në vitet paraprake dhe modelit të ri të propozuar, si dhe ka shërbyer për të kuptuar logjikën institucionale që qëndron pas këtyre ndryshimeve.

Raporti është përqendruar në komunat me më shumë se 30,000 banorë (25 komuna të trajtuara në këtë raport). Përzgjedhja është bërë duke u bazuar në rezultatet zyrtare të Regjistrimit të Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave të vitit 2024. Ky kriter është zgjedhur për disa arsye metodologjike. Së pari, komunat më të mëdha përfaqësojnë pjesën dërrmuese të nxënësve dhe mësimdhënësve në Kosovë, duke bërë që ndikimi i ndryshimeve në formulën e financimit të jetë më i dukshëm. Së dyti, këto komuna përballen me sfida më komplekse të menaxhimit të rrjetit shkollor dhe të burimeve njerëzore. Së treti, analiza e tyre ofron një pasqyrë më të qartë mbi efektet financiare që mund të ketë formula e re e grantit për arsim.

Sa i përket kufizimeve, raporti nuk synon të vlerësojë cilësinë e mësimdhënies apo performancën individuale të mësimdhënësve, por fokusohet ekskluzivisht në aspektet e politikës së financimit, planifikimit të personelit dhe ndikimit financiar në nivel komunal. Në të njëjtën kohë, analiza nuk merr në konsideratë faktorë të tjerë që mund të ndikojnë në nevojën për personel shtesë, si shpërndarja gjeografike e shkollave, klasat e kombinuara, mësimi në gjuhë të ndryshme, nevojat e veçanta arsimore apo karakteristikat specifike të zonave rurale dhe urbane, përveç rasteve kur këto elemente janë evidentuar ose veçuar gjatë intervistave me përfaqësuesit komunalë.

# 1. Efekti i zbatimit strikt të formulës së grantit të arsimit në nivel komunal

Qëllimi i Grantit për Arsim është të ofrojë mbështetje financiare për komunat në zhvillimin e sektorit të arsimit, duke mbuluar shpenzimet operative (sidomos pagat), mallrat dhe shërbimet, si dhe investimet kapitale. Pra, granti shërben si mekanizëm që u mundëson komunave të financojnë funksionimin e rregullt të institucioneve arsimore dhe njëkohësisht të mbështesin përmirësime në kushte, pajisje dhe shërbime që lidhen me arsimin.<sup>2</sup>

Deri në vitin 2025, në praktikë, komuna ka raportuar listën e mësimdhënësve dhe Ministria e ka pranuar këtë listë si referencë për numrin e mësimdhënësve, çka do të thotë se financimi i pagave ka reflektuar në masë të madhe raportimet komunale.<sup>3</sup> Kriteret deri në vitin 2025 për llogaritjen e grantit për arsim ndërlidheshin me nivelin arsimor, llojin e shkollës dhe karakteristikat e saj, duke u bazuar në raporte të ndryshme nxënës-mësimdhënës për arsimin parashkollor, fillor, të mesëm dhe profesional, si dhe duke marrë parasysh specifikat e shkollave rurale dhe nevojat për staf pedagogjik e koordinator të cilësisë. Përveç stafit mësimdhënës, deri në vitin 2025 formula e grantit ka përfshirë edhe stafin teknik-administrativ dhe ndihmës, të lidhur me numrin e objekteve shkollore.

Ndryshe nga pagat, ndarja e grantit për arsim për kategorinë për mallra dhe shërbime dhe për investime kapitale është bërë kryesisht bazuar në numrin e nxënësve. Për mallra dhe shërbime, shuma ka qenë 23 euro për nxënës (me dallime për kategori të caktuara, sipas kriterëve), ndërsa për investime kapitale shuma ka qenë 7 euro për nxënës. Kjo e bën këtë pjesë më të drejtpërdrejtë, sa më shumë nxënës, aq më e madhe nevoja për shpenzime operative jo-paga (materiale, shërbime, mirëmbajtje) dhe për investime.

Ndërsa në vitin 2026, këto kritere kanë shënuar disa ndryshime. Ka mbetur e njëjtë mënyra e llogaritjes për mallra dhe kapitale, por ka ndryshuar llogaritja e grantit për arsim sa i përket numrit të mësimdhënësve. Në vitin 2026, si dhe në planifikimin fillestar për vitin 2027, del në pah se Ministria e Financave, bazuar në rekomandimet ligjore të Ministrisë së Arsimit, nuk e llogarit më numrin e mësimdhënësve sipas listës që e paraqet komuna, por sipas numrit ekzistues të nxënësve, që rezulton dukshëm numër më i vogël i mësimdhënësve.<sup>4</sup>

Në total, 25 komunat e përfshira në këtë raport kanë paraqitur 27,282 mësimdhënës për vitin 2026, ndërsa MASHT/MF kanë aprovuar vetëm 24,200, pra 3,082 mësimdhënës më pak të aprovuar. Kjo diferencë përbën afro 11.3% të numrit të paraqitur nga komunat (ose ministria ka aprovuar rreth 88.7% të asaj që komunat kanë kërkuar).

Vetëm në 4 komuna (Prishtinë, Ferizaj, Fushë Kosovë dhe Obiliq) lista e mësimdhënësve dhe aprovimi nga MASHT/MF përputhen plotësisht. Kësisoj, komunat ku diferenca është e ulët deri në 100 mësimdhënës me pak të buxhetuar se sa kërkesa e parashtruar janë: Prizreni (27), Drenasi (33), Lipjani (58), Vushtrria (72), Kaçaniku (73), Istogu (79), Mitrovica e Jugut (88), Shtimja (88). Ndërsa komunat që preken mesatarisht deri në 200 mësimdhënës janë Klina (104), Dragashi (115), Malisheva (138), Peja (139), Deçani (144), Skenderaji (169), Rahoveci (186). Kurse komunat që kanë diferencë të lartë mes listës së paraqitur dhe asaj të aprovuar nga Ministria e Arsimit dhe ajo e Financave janë: Suhareka (205), Vitia (206), Podujeva (250), Gjakova (290), Kamenica (299), Gjilani (310).


<sup>2</sup> Gazeta Zyrtare e Kosovës. [Ligji për Financat e Pushtetit Lokal](#). Neni 25.

<sup>3</sup> Ibid

<sup>4</sup> Ministria e Financave dhe Transfereve. [Qarkoret buxhetore për komuna pas vitit 2025](#).

Si përqindje, tek komuna e Kamenicës rreth 55% e mësimdhënësve nuk janë mbuluar nga granti i arsimit, pastaj në Dragash, Viti dhe Deçan me afro 26%, dhe Rahovec e Suharekë afro 21%.

**Figura 1.** Krahasimi ndërmjet numrit të mësimdhënësve të paraqitur nga komuna për buxhetim dhe numrit të aprovuar për financim nga Ministria e Financave, bazuar në rregullat e Ministrisë së Arsimit për vitin 2026



Burimi: Instituti GAP të dhëna të bazuara në Ministria e Financave dhe Transfereve, Qarkorja buxhetore për komuna 2025/01

Mbulimi financiar i këtyre mësimdhënësve, është duke u bërë nga granti i përgjithshëm, përkatësisht, janë marrë mjete nga mallrat dhe shërbimet, si dhe një pjesë nga subvencionet.<sup>5</sup> Po thuajse të gjitha komunat e tjera janë mbuluar në të njëjtën mënyrë, çka do të thotë se mjetet e dedikuara ose të planifikuara paraprakisht për t'u shpenzuar në projekte të tjera janë orientuar për mbulimin e pagave, të cilat në vitet paraprake kanë qenë pjesë e grantit të arsimit.<sup>6</sup>

Në total, për komunat e paraqitura në figurën 2, numri i mësimdhënësve të aprovuar për vitin 2026 ishte 24,200, ndërsa numri i planifikuar/buxhetuar për vitin 2027 është 23,849. Kjo nënkupton një rënie prej 351 mësimdhënësish në total (2027 krahasuar me 2026), që shikuar në përqindje përkthehet në një ulje prej 1.5%.

Sipas planifikimit për vitin 2027 (i llogaritur sipas numrit të nxënësve) nuk pritet zgjerim i përgjithshëm i numrit të mësimdhënësve, por rishpërndarje selektive, përkatësisht rritje aty ku ka rritje të numrit të nxënësve dhe ulje aty ku numri bie.

Për vitin 2027, rritjet janë të përqendruara në një numër të vogël komunash. Prishtina jo vetëm që mbetet baza më e madhe në të dy vitet, por edhe pritet të rritet me 61 mësimdhënës (nga 3,097 në 2026 në 3,158 në 2027), duke sinjalizuar se kërkesa e re (ose minimumi presioni për kapacitete shtesë) nuk po bie. Edhe më e theksuar proporcionalisht është Fushë Kosova, që shënon rritje për 76 mësimdhënës (740 në vitin 2026 në 816 të planifikuara për vitin vijues), një rritje e konsiderueshme për madhësinë e saj, e cila sugjeron se projeksioni i nxënësve për 2027 e shtyn lart kërkesën për staf. Podujeva planifikohet të rritet po ashtu


<sup>5</sup> Intervistë me Drejtorin e Drejorisë për Buxhet dhe Financa në Komunën e Gjakovës, Durim Halilaj dhe me drejtorin e arsimit në komunën e Pejës, Naser Gega.

<sup>6</sup> Intervistë me Drejtorin e Drejorisë për Buxhet dhe Financa në Komunën e Gjakovës, Durim Halilaj.

me 29 mësimdhënës (1,215 në 1,244) në vitin 2027, ndërsa rritje të vogla, por me rëndësi indikative, kanë edhe Obiliqi me tetë mësimdhënës, Shtimja me shtatë mësimdhënës dhe Klina me tre mësimdhënës.

Në anën tjetër, shumica e komunave parashihet të kenë rënie të numrit të mësimdhënësve në vitin 2027 krahasuar me 2026, por intensiteti i uljeve nuk është i njëjtë, sikurse Lipjani me gjashtë mësimdhënës më pak, Istogu pesë, Mitrovica e Jugut dhjetë, Drenasi 12, Suhareka tetë, Rahoveci 19, dhe një grup uljesh më të mëdha si Prizreni që bie për 53, Gjilani me 42 dhe Peja me 35 mësimdhënës me pak në grantin e arsimit. Megjithatë, rasti më i rëndë është Gjakova me 139 mësimdhënës (nga 1,251 mësimdhënës që kishte në 2026 në 1,112 që janë buxhetuar për 2027).

**Figura 2.** Krahasimi ndërmjet numrit të mësimdhënësve që ka buxhetuar MF/MA për vitin 2026 dhe planifikimi i buxhetimit të grantit të arsimit sipas numrit të mësimdhënësve për vitin 2027



Burimi: Instituti GAP të dhëna të bazuara në Ministria e Financave dhe Transfereve, Qarkorja buxhetore për komuna 2026/O1. Komunat me ngjyren e kuqe në diferencë pasqyrojnë rritje të numrit të mësimdhënësve, krahasuar me një vit më herët.

Nisja e aplikimit të buxhetimit në grantin për arsim bazuar në numrin e nxënësve, lidhet drejtpërdrejt me argumentin e rënies së vazhdueshme të numrit të nxënësve dhe me nevojën për ta përshtatur sistemin arsimor sipas nevojës (jo më shumë mësimdhënës se sa numri i duhur i tyre).


Rënia e numrit të nxënësve është hasur nga periudha 2008/2009 dhe vetëm deri në fund të vitit 2020, numri i nxënësve ka rënë për 26%, apo për 114,323 nxënës me pak, që nënkupton shumë më pak paralele, më pak ngarkesë

mësimore dhe, në parim, më pak nevojë për staf. Kjo bëhet edhe më e theksuar kur merret parasysh se, megjithëse numri i nxënësve ka rënë, të dhënat tregojnë se personeli arsimor (mësimdhënës, personel administrativ dhe ndihmës) për periudhen e lartcekur është rritur për 2%.<sup>7</sup> Pra, sistemi ka lëvizur në drejtim të kundërt, më pak nxënës, por më shumë staf. Në një situatë të tillë, politikat e aplikuara nga Ministria e Financave nga viti 2026 tentojnë të frenojnë shtimin e pozicioneve të reja dhe të synojnë racionalizim ose rishpërndarje, sepse mbajtja e të njëjtit ritëm punësi si në periudhat me rritje të nxënësve po krijon kosto buxhetore pa u mbështetur në kërkesë dhe nevojë reale.

Rënia e numrit të nxënësve haset edhe në vitet e fundit, dhe kjo tregon se dinamika e rënies ose vlerësimit nga Ministria e Financave dhe ajo e Arsimit për numrin e mësimdhënësve do të jenë të vazhdueshme. Kësisoj nga 25 komunat (e përfshira në raport) numri i nxënësve në tri vitet e fundit (2024–2026) ka rënë nga 300,429 në vitin 2023/2024 në 279,465 në vitin 2026/2027, pra një rënie prej afro 21 mijë nxënësish. Shikuar sipas përqindjes tkurrja është rreth 7% brenda tri viteve shkollore.<sup>8</sup>

Rëniat më të mëdha absolute për periudhën 2023/2024 dhe 2026/2027 vërehen te Prizreni 2,332 me pak nxënës dhe Prishtina 1,967 me pak nxënës, pas tyre vijnë Gjakova 1,281 më pak nxënës, Ferizaj 1,227 më pak nxënës dhe Malisheva 1,068 më pak nxënës. Ndërsa ku rënia është me e vogël, është Obiliqi me 250 nxënës më pak, Kamenica me 344 nxënës me pak, Vitia 423 nxënës me pak dhe Dragashi 472 nxënës me pak. Ndërsa Podujeva është rasti i vetëm që në vitin e fundit 2026/27 në krahasim me vitin 2025/26 shënon rritje për 372 nxënës. Tek komunat e mëdha kjo rënie vije kryesisht për shkak të faktorëve si emigrimit dhe rënies graduale të numrit të lindjeve, ndërsa të komunat e vogla si faktor shtesë është edhe migrimi i brendshëm i qytetarëve, nga zonat rurale në ato urbane.

**Figura 3.** Numri i nxënësve që kanë paraqitur komunat te Ministria e Financave për buxhetim te granti i arsimit në tri vitet e fundit



Burimi: Instituti GAP të dhëna të bazuara në Ministria e Financave dhe Transfereve, Qarkorja buxhetore për komuna 2024/O1 & 2025/O1 & 2026/O1.

7 Instituti GAP. [Shkolla të tepërta](#). Fq 3.

8 Ministria e Financave dhe Transfereve. [Qarkoret buxhetore për komuna të vitit 2024, 2025 dhe 2026](#).

## 2. Ndikimi financiar i i zbatimit strikt të formulës së grantit të arsimit në nivel komunal

Në vitin 2026, granti i përgjithshëm për arsim për 25 komunat e analizuara në këtë raport arrin mbi 250 milionë euro, ndërsa shuma që komunat e mbulojnë me mjete vetanake jashtë grantit (si pasojë e mbajtjes së një numri më të madh të mësimdhënësve sesa lejojnë udhëzimet administrative) është mbi 23 milionë euro. Kjo do të thotë se në nivel të përgjithshëm, mbulimi vetanak përbën rreth 9.17% të grantit të vitit 2026, një sinjal i qartë kjo po prodhon një barrë financiare jo të vogël për buxhetet komunale.

Struktura e grantit 2026 është dukshëm e përqendruar në komunat e mëdha. Prishtina ka grantin më të lartë me mbi 30 milionë euro, që përfaqëson rreth 12% të totalit të grantit për 2026. Pas saj vijnë Prizreni me afro 23 milionë euro apo 9% të totalit, Ferizaj me afro 18 milionë euro apo 7% të totalit, Gjilani me mbi 14 milionë euro rreth 6%, Podujeva, Gjakova dhe Peja me afro 5.3% të vlerës së grantit. Pra, vetëm këto shtatë komuna së bashku mbajnë afërsisht 50% të gjithë grantit 2026, meqë shpërndarja ndjek formulën e numrit të nxënësëve, ku në këto komuna për vitin shkollor 2026/27 janë të paraparë 147,927 nxënës, që llogaritur në total të 25 komunave prej 279,465 nxënës i bie 53% e totalit të nxënësëve. Në nivel vendi, ndryshimet më të theksuara buxhetore tek granti për arsim në periudhën 2025–2026 vërehen te Fushë Kosova me rritje rreth 27% (nga 5,530,790 euro në 7,022,273 euro), Obiliqi me rreth 16%, Ferizaj me rreth 14%, Mitrovica e Jugut me rreth 12%, Prishtina me rreth 12% dhe Prizreni me rreth 11%. Në të kundërt, disa komuna kanë rritje minimale ose edhe rënie, si Malisheva me rënie rreth 3%. Për periudhën 2026–2027, rëniet relative më të mëdha evidentohen të Kamenica (rreth -39%), Dragashi (rreth -19%), Deçani (rreth -16%) dhe Vitia (rreth -16%).

Nga ana tjetër mbulimi i pagave nga ana e komunave të mësimdhënësëve që nuk janë buxhetuar nga granti për arsim, si vlerë absolute rezulton se presioni më i madh financiar bie mbi Gjilanin me mbi 2.5 milionë euro dhe Gjakovën me 2.3 milionë euro, vetëm këto dy komuna përbëjnë rreth 21% të gjithë shumës jashtë grantit (4,809,629 euro nga totali prej 23,016,271 euro). Më pas vijnë Peja (1,559,644 euro), Malisheva (1,466,187 euro), Podujeva (1,319,969 euro) dhe Rahoveci (1,277,167 euro).

Edhe më domethënëse është pesha financiare e këtij shpenzimi vetanak në përpjestim me grantin e përgjithshëm të arsimit për vitin 2026. Shtimja del me peshën më të lartë 750,028 euro që duhet t'i mbulojë vetë që është rreth 19% e grantit të saj për 2026. Pas saj janë Dragashi me rreth afro 18% (650,075 euro nga 3,686,739 euro sa është granti për këtë komunë), Gjilani, Rahoveci dhe Gjakova me rreth 17%. Këto përqindje janë shumë të larta për një kategori shpenzimi që në thelb vjen nga mospërputhja mes numrit të mësimdhënësëve dhe numrit të nxënësëve. Në anën tjetër, disa komuna kanë peshë shumë më të ulët jashtë grantit, si Obiliqi (73,551 euro nga 3,890,631 euro apo rreth 1.8%) dhe Fushë Kosova (129,663 euro nga 7,022,273 euro apo rreth 1.8%).

**Tabela 1.** Shuma e grantit për arsim për komunat për vitin 2025 dhe 2026, planifikimi për vitin 2027, si dhe shuma e mjeteve që komunat duhet t'i shpenzojnë nga burime të tjera për të mbajtur numrin e mësimdhënësve mbi normën e lejuar nga Ministria e Financave dhe Ministria e Arsimit.

Komunat	Granti për arsim në komuna për vitin 2025 (euro)	Granti për arsim në komuna për vitin 2026 (euro)	Granti për arsim në komuna i planifikuar për vitin 2027 (euro)	Shuma që duhet të mbulojnë komunat jashtë grantit të arsimit 2026 (euro)
Deçan	4,825,149	4,889,261	4,096,139	708,398
Dragash	3,705,015	3,686,739	2,983,845	650,075
Ferizaj	15,604,654	17,840,761	18,082,045	413,005
Fushë Kosovë	5,530,790	7,022,273	7,801,936	129,663
Gjakovë	13,164,769	13,360,099	12,500,689	2,308,721
Gjilan	14,415,178	14,463,787	13,827,809	2,500,908
Drenas	8,223,004	9,074,873	9,080,582	476,596
Istog	5,356,010	5,514,365	5,633,081	848,840
Kaçanik	4,626,225	4,672,942	4,492,490	582,030
Kamenicë	5,433,969	5,633,863	3,438,159	802,520
Klinë	5,953,349	6,103,450	5,619,727	360,637
Lipjan	8,837,533	9,827,792	10,094,130	731,941
Malishevë	8,915,744	8,670,013	8,757,420	1,466,187
Mitrovicë e Jugut	10,064,386	11,302,590	11,682,190	1,038,401
Obiliq	3,340,714	3,890,631	4,056,661	73,551
Pejë	12,810,169	13,083,237	13,038,791	1,559,644
Podujevë	13,190,988	13,477,993	13,057,827	1,319,969
Prishtinë	27,093,624	30,372,147	31,801,112	572,792
Prizren	20,247,089	22,604,239	22,842,065	417,769
Rahovec	7,330,156	7,387,402	6,843,506	1,277,167
Shtime	3,954,859	3,997,788	3,999,443	750,028
Skenderaj	7,286,969	7,536,404	7,060,106	1,124,342
Suharekë	8,596,834	8,820,745	8,145,221	1,178,807
Viti	6,887,654	7,073,870	5,930,173	844,478
Vushtrri	9,861,291	10,609,832	10,703,206	879,802
<b>Totali</b>	<b>235,256,122</b>	<b>250,917,096</b>	<b>245,568,353</b>	<b>23,016,271</b>

Burimi: Të dhëna të përpunuara nga Instituti GAP bazuar në Ministria e Financave dhe Transfereve, Qarkorja buxhetore për komuna 2024/01 & 2025/01 & 2026/01.

### 3. Përfundim dhe rekomandime

Zbatimi i formulës së Grantit Specifik të Arsimit nga viti 2026, ku financimi i pagave lidhet më drejtpërdrejt me numrin e nxënësve dhe raportit nxënës-mësimdhënës, e ka bërë më të dukshme hendekun mes strukturës aktuale të stafit. Rënia e vazhdueshme e nxënësve (me tkurrje të ndjeshme në shumicën e komunave të përfshira) do të thotë se sistemi po operon me një kosto të lartë që nuk përshtatet automatikisht me kërkesën. Në këtë kuptim, politika e re nuk është vetëm ndërhyrje buxhetore, por një sinjal i qartë për nevojën e komunave për rristurimit të menaxhimit të burimeve njerëzore dhe rrjetit shkollor në nivel lokal.

Të dhënat e vitit 2026 tregojnë se një pjesë e konsiderueshme e numrit të mësimdhënësve të paraqitur nga komunat nuk konsiderohen më të financueshme brenda grantit të arsimit, duke krijuar një realitet të ri: komunat ose duhet të harmonizojnë stafin, ose të mbajnë stafin shtesë me burime vetanake. Në praktikë, kjo e dyta po ndodh gjerësisht përmes zhvendosjes së mjeteve nga zërat jo-paga (mallra, shërbime, subvencione, apo investime).

Nëse kjo dinamikë vazhdon edhe në vitet në vijim, rreziku kryesor është i dyfishtë. Së pari, krijohet presion i vazhdueshëm mbi buxhetet komunale, duke e dobësuar ose kufizuar potencialin buxhetor të komunave (edhe ashtu të sfiduar viteve të fundit nga dukuria e përbarimeve) dhe së dyti, rriten pabarazitë ndërmjet komunave, ato me të hyra më të mëdha e përballojnë më lehtë koston, ndërsa komunat më të vogla ose me rrjet të shpërndarë shkollash rrezikojnë reduktim të shërbimeve dhe investimeve, për të ruajtur pagat. E ndryshimet demografike, sikurse një trend rënës i lindjeve në vend dhe emigrimi i qytetarëve jashtë vendit, japin sinjal që kjo dinamikë do të vazhdojë.

Ky raport nënvizon se debati "tepricë apo nevojë" nuk mund të reduktohet në numrin total të mësimdhënësve. Për disa komuna, hendeku i madh sinjalizon jo vetëm tepricë potenciale, por edhe problem të modelit organizativ: shkolla me pak nxënës, klasa të vogla, shpërndarje e rrjetit që nuk është përshtatur me lëvizjet demografike, dhe planifikim i pamjaftueshëm i rotacionit të stafit (pensionime, transferime, rikualifikime). Në këtë kontekst, rishikimi i rrjetit shkollor duhet të trajtohet si proces i rregullt planifikimi dhe jo si vendim ad-hoc, ndërsa menaxhimi i personelit duhet të lidhet me të dhëna të verifikueshme për numrin e nxënësve, paralelet, lëndët deficitare dhe distancat mes objekteve dhe popullatës, përkatësisht nxënësëve.

Element i rëndësishëm është edhe perspektiva 2027 dhe projeksionet pasuese: planifikimi tregon rishpërndarje selektive, me rritje aty ku rritet numri i nxënësve dhe ulje aty ku bie. Kjo e bën të domosdoshëm një mekanizëm të parashikueshëm tranzicioni, komunat duhet të kenë instrumente për ta ulur gradualisht stafin aty ku ka tepricë (p.sh. pensionim i parakohshëm, ngrirje e punësimeve të reja, mobilitet brenda komunës/ndërkomunal, riangazhim në role mbështetëse), pa dëmtuar lëndët ku ka mungesa reale. Pa një tranzicion të tillë, politika e re rrezikon të prodhojë tensione sociale dhe ulje të motivimit, pa e arritur racionalizimin e synuar.

Në përfundim, gjetjet tregojnë se reforma e grantit ka ekspozuar një mospërputhje strukturore në arsim: rënia e nxënësve nuk është shoqëruar me riorganizim proporcional të rrjetit dhe mësimdhënësve. Në afat të shkurtër, efekti kryesor është zhvendosja e koston te komunat, në afat të mesëm, sfida bëhet ruajtja e cilësisë së shërbimit arsimor duke mos e lejuar që mbulimi i pagave të rrezikojë investimet dhe shërbimet.

Nisur nga kjo, por edhe nga gjetjet dhe konstatimet e tjera të këtij raporti, Instituti GAP rekomandon:

- Komunat të cilat kanë të punësuar një numër shumë më të lartë mesimdhënësish sesa nevojiten, duhet të pezullojnë proceset e rekrutimit të stafit të ri në sektorin e arsimit, me qëllim të mos krijimit të barrës financiare për komunën. Po ashtu, ato duhet të nisin procesin e riorganizimit të sistemit arsimor, përmes racionalizimit të rrjetit shkollor (bashkimit/fuzionimit të objekteve shkollore), si dhe bartjes së nxënësve në objekte më të përshtatshme, me një numër të qëndrueshëm dhe të kënaqshëm nxënësish.
- Komunat duhet të organizojnë konsultime publike të strukturuar dhe gjithëpërfshirëse para dhe gjatë procesit të riorganizimit të rrjetit shkollor, me qëllim që vendimet të bazohen në informim të plotë, të kenë legjitimitet publik dhe të minimizohet ose evitohet rezistenca sociale.
- Komunat me numër "mbi normë" mesimdhënësish, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave, duhet të shqyrtojnë mundësinë e ofrimit të skemave të pensionimit të parakohshëm për një numër të caktuar mesimdhënësish, me qëllim të uljes së barrës buxhetore nga shpenzimet për stafin "mbi normë" dhe krijimit të hapësirës financiare për menaxhim më të qëndrueshëm të burimeve njerëzore në arsim. Por, pensionimi i parakohshëm nuk duhet të përfshijë kuadrot deficitare.
- Komunat duhet të nisin dhe të koordinojnë procesin e ristrukturimit të stafit në sistemin arsimor. Nëse ky proces ndërmerret, duhet të hartohet një plan i qartë ristrukturimi për tri (3) vitet e ardhshme dhe t'u kërkolet Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Arsimit që, gjatë një periudhe tranzitore trevjeçare, të përfshijnë të gjithë mesimdhënësit në grantin për arsim, me qëllim të lehtësimit të barrës buxhetore për komunat.
- Ministria e Arsimit duhet të luajë një rol më aktiv në ofrimin e mbështetjes profesionale për komunat, veçanërisht në planifikimin, koordinimin dhe menaxhimin e nismave të mundshme për ristrukturimin e stafit dhe të objekteve shkollore.



Instituti GAP është think-tank i themeluar në tetor të vitit 2007 në Kosovë. Qëllimi kryesor i GAP-it është të tërheqë profesionistë për të krijuar një ambient të zhvillimit dhe hulumtimit profesional, që haset në institucione të ngjashme në shtetet perëndimore. Kjo gjithashtu u ofron mundësi kosovarëve për hulumtimin, zhvillimin dhe implementim e projekteve me qëllim të avancimit të shoqërisë kosovare. Prioritet për këtë Institut është mobilizimi i profesionistëve në adresimin e sfidave ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Qëllimet kryesore të GAP-it janë të plotësojë zbrazëtitë mesqeverisë dhe qytetarëve, si dhe të plotësojë zbrazëtitë në mes të problemeve dhe zgjidhjeve.

[www.institutigap.org](http://www.institutigap.org)

Sejdi Kryeziu, Blloku 4, Nr. 4, 10000 Prishtinë

Tel.: +383 38 609 339

[info@institutigap.org](mailto:info@institutigap.org)

Instituti GAP përkrahet nga programi i Fondacionit Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) 'EJA Kosovë', bashkëfinancuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe Suedia.

Përmbajtja e këtij dokumenti është përgjegjësi e Institutit GAP dhe jo domosdoshmërisht paraqet qëndrimet e KCSF-së, SDC-së apo Suedisë.



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

**Swiss Agency for Development  
and Cooperation SDC**



Sweden  
Sverige



FONDACIONI KOSOVAR PËR SHOQËRI CIVILE  
KOSOVAR CIVIL SOCIETY FOUNDATION

